



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr- 28/2008”, nenit 11, 15 dhe 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, konform, Vendimeve të Kuvendit Komunal në Suharekë të miratuar në vitin 2003, për ndarjen e shpërblimeve të cekura më poshtë, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

Për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve “Emblema e artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjen “13 Qershori”

Neni 1

Shpërblimi **“Emblema e artë”** i ndahet, **Hysen Q. GEGAJ** nga fshati Sallagrazhd Komuna e Suharekës (postmortum).

Neni 2

Shpërblimi **“Skënderbeu”** i ndahet: **1. Mehemetali J. AJVAZI** nga fshati Livoq i Epërm Komuna e Gjilanit, **2. Shyqeri Z. AJVAZI** nga fshati Livoq i Epërm Komuna e Gjilanit, **3. Lulzim VESELAJ** nga fshati Reqan Komuna e Suharekës dhe **4. Fatime ELSHANI-BERISHA** nga Suhareka (postmortum).

Neni 3

Mirënjohja **“13 Qershori”** i ndahet këtyre të nominuarëve: **1. Rifat I. ALIAJ** nga fshati Maqitevë (postmortum), **2. Sherif Sh. SELLAJ** nga fshati Samadrexhë (postmortum), **3. Ilmi R. BUJARI** nga fshati Duhël, **4. Mehmet H. MUSTAFA** nga fshati Mushtisht dhe **5. Të gjithë Ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në tekstin e mëtejme (UÇK) të Komunës së Suharekës, që kanë qenë pjesëtar të “Brigadës 138 Agim Ramadani” në Koshare.**

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI